



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1290 / Prot.
3

Tiranë, më 4.01.2017

VENDIM

Nr. 01 ,datë 4/1/2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1290 datë 17.11.2016 me objekt, “Ankim për refuzimin ndaj dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, ndaj autoritetit publik/Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Qendra “Res Publica” ka kërkuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, dokumentacionin dhe informacionin e disponueshëm si më poshtë vijon:

Në lidhje me shkresën nr.222/16prot:

1. Kopje të strukturës organizative;
2. Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit;
3. Kopje të strukturave të pagave për nëpunësit e tjerë;
4. Kopje të Rregullores së Brendshme të institucionit.

Në lidhje me shkresën nr.223/16prot:

1. Kopje të planeve strategjike të punës;
2. Kopje të buxhetit për vitin 2015-2016;
3. Kopje të planit të shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe për vitet e kaluara për periudhën 2014-2016;
4. Kopje të dokumenteve që përmbajnë tregues të performacës së autoritetit;
5. Cilat janë mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik;

6. *Kopje të raporteve të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga subjekte të tjera;*
7. *Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
8. *Cilat janë mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

Në lidhje me shkresën nr.224/16prot:

1. *Cilat janë shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë dhe standartet për cilësinë e shërbimit;*
2. *Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;*
3. *Cilat janë mekanizmat apo procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;*
4. *Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;*
5. *Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.*

Në lidhje me shkresën nr.225/16prot:

1. *Sa është numri i kërkesave dhe përgjigjeve që i janë bërë autoritetit publik në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2016 duke vendosur në dispozicion një kopje të të gjitha përgjigjeve që i është dhënë subjektit kërkuar;*
2. *Cilat janë informacionet dhe dokumentat që kërkohen më shpesh në institucionin tuaj.*

Ankuesi pretendon se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, me Urdhrin nr. 256 Prot, datë 05.12.2016, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesat e Qendrës “Res Publica”, janë depozituar pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe janë regjistruar me nr.4405/1Prot., datë 26.10.2016; me nr.4405/2Prot., datë 26.10.2016; me nr. 4405/3 Prot., datë 26.10.2016; me nr. 4405/4 Prot., datë 26.10.2016. Gjithashtu, u konstatua se Autoriteti Publik/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kthyer përgjigje për një pjesë të kërkesave të Qendrës “Res Publica”, me anë të shkresave nr.4405/41Prot., datë 04.11.2016; nr. 4405/21 Prot., datë 04.11.2016 dhe shkresës nr. 4405/22 Prot., datë 04.11.2016, kopje të të cilave u administruan nga Zyra e Komisionerit, si prova për të shqyrtuar me tej nëse janë përmbushur detyrimet ligjore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të marrë gjatë inspektimit rezulton se Autoriteti Publik/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, nuk ka përmbushur detyrimin duke mos kthyer përgjigje për informacionin e kërkuar me anë të shkresave nr.224/16prot dhe nr.225/16prot.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të marrë gjatë inspektimit, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, informacioni i kërkuar nga Qendra “Res Publica”, përbën informacion publik. Në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave të administruara, Komisioneri konstaton se shkelja e kryer është mos trajtimi i kërkesës në tërësinë e objektit të saj, e provuar kjo jo vetëm nga pretendimet e ankuesit në ankesë por edhe nga konstatimi i grupit të inspektimit në zyrat e Autoritetit Publik/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Informacioni i kërkuar është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Çdo autoritet publik, në kuptim të nenit 7 të Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës informacionin lidhur me:

Kopje të strukturës organizative; Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit; Kopje të strukturave të pagave për nëpunësit e tjerë; Kopje të Rregullores së Brendshme të institucionit; Kopje të planeve strategjike të punës; Kopje të buxhetit; Kopje të planit të shpenzimeve; Kopje të dokumenteve që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit; Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik; Kopje të raporteve të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga subjekte të tjera; Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; Mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme; Shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë dhe standartet për cilësinë e shërbimit; Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; Cilat janë mekanizmat apo procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimit të funksioneve të autoritetit publik; Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfutur ato; Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit; informacionet dhe dokumentat që kërkohen më shpesh.

Gjithashtu bazuar në nenin 8 të Ligjit 119/2014 autoriteti publik duhet të kishte të publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve ku të pasqyrohej numri i kërkesave dhe përgjigjeve që i janë bërë autoritetit publik në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2016 duke vendosur në dispozicion një kopje të të gjitha përgjigjeve që i janë dhënë subjektit kërkuar;

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar nga Qendra “Res publica”, jo vetëm duhet vënë në dispozicion të kërkuarit por duhet të jetë publik në programin e transparencës së Autoritetit Publik.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” ndaj Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendra "Res Publica", nr. 1290 datë 17.11.2016 kundër autoritetit publik/Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e autoritetit publik/ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për vënien në dispozicion ankuesit, të dokumentacionit të kërkuar me anë të shkresës nr.224/16prot:
 1. Shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë dhe standartet për cilësinë e shërbimit;
 2. Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
 3. Mekanizmat apo procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
 4. Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;
 5. Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.dhe dokumentacionin e kërkuar me anë të shkresës nr.225/16prot:
 1. Numri i kërkesave dhe përgjigjeve që i janë bërë autoritetit publik në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2016 duke vendosur në dispozicion një kopje të të gjitha përgjigjeve që i është dhënë subjektit kërkuar;
 2. Informacionet dhe dokumentat që kërkohen më shpesh në institucionin tuaj, brenda datës 12.01.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 04.01.2017.

